BASHKIA SHKODER

# KUJDESI SOCIAL PËR PERSONAT E SËMURË

2020 – 2022

## Programi Buxhetor: 10140 - Kujdesi social për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara

## PËRSHKRIMI I PROGRAMIT

Në këtë program buxhetor bashkia planifikon shpenzimet buxhetore për ofrimin e përfitimeve monetare ose në natyrë, si asistencë për detyrat e përditshme për personat përkohësisht të paaftë për punë për shkak sëmundjeje ose dëmtimi (ndihmë shtëpiake, lehtësi transporti etj.), personat plotësisht ose pjesërisht të paaftë për veprimtari ekonomike, etj. Bashkia planifikon dhe ofron mbështetje dhe përfitime në natyre, si: vakte ushqimi për personat e paaftë, në ambjete të përshtatshme, si dhe ndihma të tjera të përfshira në skemat e mbrojtjes shoqërore;

### Shpenzimet e Programit buxhetor 2017 – 2022

| Kodi | Fakt 2017 | Fakt 2018 | I Pritshmi 2019 | Plan 2020 | Plan 2021 | Plan 2022 |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 10140 | 18,064 | 17,094 | 24,688 | 36,633 | 36,637 | 38,445 |




### Shpenzimet e Programit sipas klasifikimit ekonomik

| | Shpenzimet korrente | Investimet |
|---|---|---|
| **Fakt 2017** | 18,064 | 0 |
| **Fakt 2018** | 17,094 | 0 |
| **I Pritshmi 2019** | 24,688 | 0 |
| **Plan 2020** | 36,633 | 0 |
| **Plan 2021** | 36,637 | 0 |
| **Plan 2022** | 38,445 | 0 |



## Treguesit Kyç të Performancës

**Qëllimi i programit**

Krijimi dhe administrimi i shërbimeve sociale për shtresat në nevojë, personat me aftësi të kufizuar, fëmijët, gratë, të moshuarit etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj

**Objektivi 1**

Partneriteti i ngushtë me shoqërinë civile, organizatat jo-fitimprurëse, biznesin privat dhe biznesin social në veçanti për ofrimin e shërbimeve sociale për shtresat në nevojë

| Treguesit e rezultatit | *Njësia Matëse* | Synimet 2018 | 2019 | 2020 | 2021 | 2022 | Trendi |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Rritja e përftuesve të shërbimeve ekzistuese dhe atyre alternative në sajë të partneritetit me shoqërinë civile, organizatat jo-fitimprurëse, biznesin privat dhe biznesin social. | *Numri i fëmijëve përfitues të shërbimeve ekzistuese dhe atyre alternative (ndryshimi vjetor në %)* | | **33%** | **15%** | **9%** | **0%** | ↑ |
| | *Numri i fëmijëve përfitues të shërbimeve ekzistuese dhe atyre alternative (ndryshimi vjetor në %)* | | **38%** | **11%** | **15%** | **0%** | ↑ |

**Qëllimi i programit**

Krijimi dhe administrimi i shërbimeve sociale për shtresat në nevojë, personat me aftësi të kufizuar, fëmijët, gratë, të moshuarit etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj

**Objektivi 2**

Krijimi i fondit të dedikuar për mbështetjen e PAN në bashkërendim me Shoqërinë Civile

| Treguesit e rezultatit | *Njësia Matëse* | Synimet *2018* | 2019 | 2020 | 2021 | 2022 | Trendi |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Rritja shërbimeve në ndihmë të personave PAN | *Shtëpi funksionale në ndihmë të PAN* | | **7** | **7** | **7** | **7** | |
| | *Numri i përfituesve nga mirëfunksionimi i sistemit të referimit (ndryshimi vjetor në %)* | | **2%** | **30%** | **0%** | **0%** | |
| | *Nr. i rasteve të parandaluara drejt institucionalizimit të PAN, ndryshimi vjetor në %* | | | **50%** | **25%** | **0%** | |
| | *Fëimijë PAN të mbështetur për pjesëmarrje në aktivitete të ndryshme* | | **25** | **25** | **25** | **25** | |
| | *Aktivitete ndërgjegjësuese, rritja vjetore në %* | | | **25%** | **40%** | **0%** | |

## TË DHËNAT E PROGRAMIT

| Fakt 2018 | I Pritshmi 2019 | Plan 2020 | Plan 2021 | Plan 2022 |
|---|---|---|---|---|
| **INDIVIDË PAN TË AKOMODUAR NË QENDRAT REZIDENCIALE** | | | | |
| 157 | 157 | 157 | 157 | 157 |
| **NUMRI I SHTËPIVE FAMILJE** | | | | |
| | 8 | 8 | 8 | 8 |
| **NUMRI I AKTIVITETEVE NDËRGJEGJËSUESE** | | | | |
| | 4 | 5 | 7 | 7 |

## TË DHËNAT E PROGRAMIT

| Fakt 2018 | I Pritshmi 2019 | Plan 2020 | Plan 2021 | Plan 2022 |
|---|---|---|---|---|
| **RASTE TË PARANDALUARA DREJT INSTITUCIONALIZIMIT TË PAN** | | | | |
| | 8 | 12 | 15 | 15 |
| **NUMRI I PËRFITUESVE TË MBËSHTETUR NË SHTËPI FAMILJE** | | | | |
| 60 | 62 | 63 | 82 | 82 |

## Aktivitetet Kryesore

Aktivitetet kryesore të parashikuara për t'u realizuar gjatë 2020 – 2022 janë:

- Partneriteti i ngushtë me shoqërinë civile, organizatat jo-fitimprurëse, biznesin privat dhe biznesin social në veçanti për ofrimin e shërbimeve sociale për shtresat në nevojë
- Krijimi i fondit të dedikuar për mbështetjen e PAN në bashkërendim me Shoqërinë Civile për ofrimin e shërbimeve.

# Funksioni:

## Nënprogrami 101: Sëmundje dhe paaftësi

### *Programi 10140: Kujdesi social për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara*

| Vështrim i përgjithshëm | | |
|---|---|---|
| Krijimi dhe administrimi i shërbimeve sociale, në nivel vendor, për shtresat në nevojë, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët, gratë, gratë kryefamiljare, gratë e dhunuara, viktima të trafikut, nëna apo prindër me shumë fëmijë, të moshuarit etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj. | | |
| Emri i Programit | Përshkrimi i programit | Përshkrimi i programit |
| 10140 | Kujdesi social për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara | • Përfitime monetare ose në natyrë, si asistencë për detyrat e përditshme për personat përkohësisht të paaftë për punë për shkak sëmundjeje ose dëmtimi (ndihmë shtëpiake, lehtësi transporti etj.);<br>• Përfitime monetare ose në natyrë për personat që janë plotësisht ose pjesërisht të paaftë të merren me veprimtari ekonomike ose të bëjnë një jetë normale për shkak të një gjymtimi fizik ose mendor;<br>• Përfitime në natyrë, si: vakte ushqimi që u jepen personave të paaftë në ambjente të përshtatshme, ndihmë që u jepet personave të paaftë për t'i ndihmuar në detyrat e përditshme (ndihmë shtëpiake, lehtësi transporti etj.), pagesë ditore për personin që kujdeset për personin e paaftë, trajnim profesional e trajnim tjetër i dhënë për të nxitur rehabilitimin në punë dhe atë shoqëror të personave të paaftë, shërbime dhe përfitime të ndryshme dhënë personave të paaftë, për të marrë pjesë në veprimtari kulturore dhe zbavitëse ose për të udhëtuar apo për të marrë pjesë në jetën e komunitetit;Administrim, vënie në funksionim ose mbështetje për skema të mbrojtjes shoqërore. |

| Qëllimet | Objektivat | Treguesit e rezultatit | Njësia matëse | Synimet | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | 2019 | 2020 | 2021 | 2022 |
| Krijimin dhe administrimin e shërbimeve sociale për shtresat në nevojë, personat me aftësi të kufizuar, fëmijët, gratë, të moshuarit etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj. | **O1.**Partneriteti i ngushtë me shoqërinë civile, organizatat jo-fitimprurëse, biznesin privat dhe biznesin social në veçanti për ofrimin e shërbimeve sociale për shtresat në nevojë. | Rritja e përftuesve të shërbimeve ekzistuese dhe atyre alternative në sajë të partneritetit me shoqërinë civile, organizatat jo-fitimprurëse, biznesin privat dhe biznesin social. | Nr. i aktiviteteve ndërgjegjësuese; | 4 | 5 | 7 | 7 |
| | | | Numri i fëmijëve përfitues të shërbimeve ekzistuese dhe atyre alternative (ndryshimi vjetor në %) | 33% | 15% | 9% | 0% |
| | | | Numri i fëmijëve përfitues të shërbimeve ekzistuese dhe atyre alternative (ndryshimi vjetor në %) | 38% | 11% | 15% | 0% |
| | | | Nr. partneriteteve me shoqërinë civile, organizatat jo-fitimprurese, | Këto aktivitete synohen të organizohen në bashkëpunim me instittucionet publike si Qendra e Zhvillimit e shkolla "3 Dhjetori" dhe organizatat partnere si: Projekti Shpresa, The Door, Shoqata e Para Tetraplegjikeve, Shpresë për Botën, Madoninna del Grappa. | Koordinimi i aktiviteteve ndërgjegjësuese në bashkëpunim me institucionet publike dhe organizatat me qëllim integrimin e personave me aftësi ndryshe në jetën socio-ekonomike. në bashkëpunim me organizatat partnere të Bashkisë së Shkodrës. | Koordinimi i aktiviteteve ndërgjegjësuese në bashkëpunim me institucionet publike dhe organizatat me qëllim integrimin e personave me aftësi ndryshe në jetën socio-ekonomike. me, në bashkëpunim me organizatat partnere të Bashkisë së Shkodrës. | Koordinimi i aktiviteteve ndërgjegjësuese në bashkëpunim me institucionet publike dhe organizatat me qëllim integrimin e personave me aftësi ndryshe në jetën socio-ekonomike. me, në bashkëpunim me organizatat partnere të Bashkisë së Shkodrës. |
| | **O2**.Krijimi i fondit të dedikuar për | Rritja shërbimeve në ndihmë të | Nr. i shtëpive familje funksionale dhe | 8 | 8 | 8 | 8 |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | mbështetjen e personave me AN në bashkërendim me Shoqërinë Civile. | personave PAN | në shërbim të PAN. | | | | |
| | | | Numri i përfituesve nga mirëfunksionimi i sistemit të referimit (ndryshimi vjetor në %) | 2% | 30% | 0% | 0% |
| | | | Shërbimet e ofruara për PAN-të në shtëpi-familje; | Akomodimi në shtëpi – familje, Përkujdesje sociale, shërbime psiko-klinike, infermieror, integrim social. | Akomodimi në shtëpi – familje, Përkujdesje sociale, shërbime psiko-klinike, infermieror, integrim social. | Akomodimi në shtëpi – familje, Përkujdesje sociale, shërbime psiko-klinike, infermieror, integrim social. | Akomodimi në shtëpi – familje, Përkujdesje sociale, shërbime psiko-klinike, infermieror, integrim social. |
| | | | Nr. i rasteve të parandaluara drejt institucionalizimit të personave me AN (ndryshimi vjetor në %) | | 50% | 25% | 0% |
| | | | Nr. i fëmijëve në nevojë që marrin pjesë dhe performojnë në aktivitetin artistiko-kulturor. | 25. | 25 | 25 | 25 |

| **Projekte të rëndësishme** në mijë lekë | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Kodi projektit** | **Titulli dhe përshkrim i shkurtër i projektit** | **Buxheti 2020 (mijë lekë)** | **Buxheti 2021 (mijë lekë)** | **Buxheti 2022 (mijë lekë)** |
| P10140.O1.A1. | Aktivitet ndërgjegjësues në kuadër të ditës ndërkombëtare për Personat me Aftësi Ndryshe, më 3 Dhjetor. | 100 | 100 | 100 |
| P10140.O2.A1. | Projekti "Shpresa" për përsonat e braktisur dhe me aftësi ndryshe; | 19 564 | 19 564 | 20 542 |
| P10140.O2.A2. | Mbështetja e trupës muzikore të Personave me Aftësi Ndryshe" | 369 | 373 | 373 |
| P10140.O2.A3. | Shtëpi Familje për persona me aftësi të kufizuar nga Opera Madonnina del Grappa | 16 600 | 16 600 | 17 430 |

| **Të dhënat e programit / Vitet** | | **2018** | **2019** | **2020** | **2021** | **2022** |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Fonde te shpenzuara per M&O dhe investime për qendra residenciale për PAK | | | | | |
| 2 | Numri i personave me aftësi të kufizuara të akomoduar në qendrat e shërbimeve sociale | **157** | **157** | **157** | **157** | **157** |
| 3 | Numri i shërbimeve të ofruara për PAK-të në shtëpi-familje | **7** | **7** | **7** | **7** | **7** |

| **Informacion financiar / në mijë lekë** | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | **2017** | **2018** | **2019** | **2020** | **2021** | **2022** |
| Tavani i përgjithshëm i programit | | | | 36,633 | 36,637 | 38,445 |
| Shpenzime bruto | 18,064 | 17,094 | 24,688 | 36,633 | 36,637 | 38,445 |
| Të ardhurat e programit | 17,901 | 16,628 | 21,204 | 36,164 | 36,164 | 37,972 |
| Shpenzime neto | 163 | 466 | 3,484 | 469 | 473 | 473 |
| Paga dhe sigurime shoqërore | | | | - | - | - |
| Investimi kapital | - | - | - | - | - | - |

**Komente**

**Programi 10140: Kujdesi social per personat e semure dhe me aftesi te kufizuara,** ka si burim financimi te ardhurat qe vijne kryesisht nga transferta specifike qe ze mesatrisht 96.4%. Ndersa shpenzimet neto jane shpenzime qe mbulohen nga te ardhurat e bashkise dhe transferta e pakushtezuar per funksionin e semundjeve dhe paaftesise. Pjesen e shpenzimeve e zene 100% shpenzimet korrente per vitet 2020, 2021 dhe 2022.

| | | |
|---|---|---|
| **Nr. 01** | **Projektit: P10140.O1.A1.**<br><br>Aktivitet ndërgjegjësues në kuadër të ditës ndërkombëtare për Personat me Aftësi Ndryshe, më 3 Dhjetor. | **Funksioni 10:** MBROJTJA SOCIALE<br><br>**N/Funksioni 101:** Sëmundje dhe paaftësi<br><br>**Llojet e Programit 10140:** Kujdesi social për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara |

**a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:**

**i. Situata**

Në kuadër të "3 Dhjetorit" ditës ndërkombëtare për Personat me Aftësi Ndryshe janë organizuar aktivitete ndërgjegjësuese në bashkëpunim me institucionet publike, organizatat, donatorët, si dhe nga vetë përfituesit, me qëllim integrimin e personave me AN në jetën, sociale, ekonomike e kulturore të zhvilluara në territorin e Bashkisë së Shkodrës. Në territorin e Bashkisë së Shkodrës PAK ndihen të përjashtuar jo vetëm për shkak të aftësive tyre ndryshe, por edhe për shkak të barrierave fizike që ekzistojnë në institucionet publike dhe private.
Për këtë është me rëndësi organizimi i aktiviteteve ndërgjegjësuese, sensibilizuese për PAK-të për t'i dhënë mundësinë këtij target grupi të shfaqin aftësitë e tyre në prezantimin e punimeve të realizuara nga vetë ata, në mënyrë që komuniteti t'i vlerësojë dhe t'i konsiderojë si pjesë e rëndësishme e shoqërisë.

**ii. Synimi i projektit**

- Synojmë ndërgjegjësimin e komunitetit, institucioneve publike dhe organizatave, por edhe të përfituesve për t'u bërë pjesë dhe për t'u përfshirë në proçesin e integrimit të personave me aftësi ndryshe në jetën, sociale, ekonomike e kulturore.
- Përfshirjen e përsonave me Aftësi Ndryshe në jetën sociale.

**iii. Aktivitetet kryesore të projektit**

- Aktivitete sensibilizuese
- Panair me punime nga vetë PAK.
- Performacë e Bandës muzikore të PAK
- Organizim i aktivitetit social – kulturore nga fëmijët e qendrës kulturore/nxënësit e shkollave.
- Hapje e Qendres së Zhvillimit me aktiviteteve dhe pjesmarrje të OJF e komunitet.

**b) Rezultatet që prisni**

- Ndërgjegjësimi i komunitetit, institucioneve dhe organizatave
- Zhvillimi i aktivitetit social – kulturor me pjesëmarrjen e PAN-ve dhe fëmijëve të qendrës kulturore dhe nxënësve të shkollave.

| **c) Aktorët e mundshëm** | **d) Kontributet e mundshme në projekt** |
|---|---|
| Personat me aftësi ndryshe<br>Komuniteti; Institucionet publike; OJF-të | Bashkia<br>Institucionet publike; Shkolla "3 Dhjetori", Qendra e Zhvillimit, Qendra Kulturore e Fëmijëve, OJF-të; Bizneset private; Komuniteti |

**e) Shpenzimet e llogaritura**

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2020** | | **Totali (mijë lekë)** | **Nga kjo:** | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | **Paga** | **Sigurime** | **Operative** | **Transferime** | **Kapitale** |
| A.1 | Refreshment | 100 | | | 100 | | |
| | **Shuma** | **100** | | | **100** | | |

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2021** | | **Totali (mijë lekë)** | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | Refreshment | 100 | | | 100 | | |
| | **Shuma** | **100** | | | **100** | | |

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2022** | | **Totali (mijë lekë)** | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | kapitale |
| A.1 | Refreshment | 100 | | | 100 | | |
| | **Shuma** | **100** | | | **100** | | |

| **f) Periudha e zbatimit** | **g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:** |
|---|---|
| Nëntor – Dhjetor 2020<br>2021<br>2022 | Stafi i Drejtorisë së Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik<br>Stafi i Qendrës së Zhvillimit<br>Organizatat<br>Qendra Kulturore e Fëmijëve |

| | |
|---|---|
| | ZA Shkodër<br>**Institucioni Likujdues:** Bashkia Shkodër |

| | | |
|---|---|---|
| **Nr. 02** | **Projekti: P10140.O2.A1.**<br>Projekti "Shpresa" për përsonat e braktisur dhe me aftësi ndryshe | **Funksioni 10:** MBROJTJA SOCIALE<br>**N/Funksioni 101:** Sëmundje dhe paaftësi<br>**Llojet e programit 10140:** Kujdesi social për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara |

**a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:**

**i. Situata**

Projekti Shpresa, është një organizatë e liçensuar që ofron shërbim të përkujdesit social të tipit shtëpi-familje, për PAN-të e braktisur nga familja dhe të deinstitucionalizuar. Kjo organizatë, është krijuar dhe vepron në qytetin e Shkodrës që prej vitit 1995. Projekti "Shpresa" ka 7 shtëpi-familje, të shpërndara në komunitet dhe aktualisht marrin shërbim 62 persona me aftësi ndryshe.
Projekti "Shpresa", duke ofruar shërbime alternative për personat me aftësi ndryshe, të cilët janë pa asnjë përkujdes dhe interesim familjar, dhe me problematika të ndryshme, ka nevojë për mbështetje financiare dhe vëmendje të shtetit. Mbështetja e projektit "Shpresa" është një domosdoshmëri, për të ofruar shërbimin sipas standarteve të përcaktuara në ligj për personat me aftësi ndryshe dhe përmbushjen e nevojave sipas rasteve specifike.
Në vitin 2017, bashkia Shkodër, projektit "Shpresa", i ka mbuluar përveç fondit për paga dhe sigurime shoqërore për 24 punonjës të personelit, gjithashtu ka mbuluar dhe pagat për administratorin e shtëpi familjes, si dhe psikologun klinik dhe infermierin.
Përveç pagesës për personelin, Bashkia Shkodër ka mbështetur Projektin "Shpresa" duke mbuluar, kuotën ushqimore për personat me aftësi ndryshe të sistemuar pranë kësaj shtëpi Famije dhe energjinë elektrike sipas marrëveshjes së bashkëpunimit mes Bashkisë Shkodër dhe Projektit Shpresa.
Projekti Shpresa me kërkesën e dërguar me email, ka kërkuar që të bëhet shpërndarja e fondeve, në mbështetje të ligjit nr.121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë".
VKM nr. 717, datë 23.06.2009 " Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nënpunësve të disa institucioneve buxhetore",të ndryshuar, (lidhja II,klasa VIII për Kujdestarët Social).
VKM nr. 187 ,datë 08.03.2017 "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nënpunësve civilë/nënpunësve,zëvëndësministrit dhe nënpunësve të kabineteve,Kryeministri,Aparatet e ministrive të linjës,Administratën e Presidentit,Kuvendit,KQZ,Gjykatën e Lartë,Prokurorinë e Përgjithshme,disa institucione të pavarura,institucione në varësi të Kryeministrit,Institucionet në varësi të Kryeministrit,Institucionet në varësi të Ministrave të Linjës dhe administratën e Prefektit, Lidhja I,Klasa IIIb për Titullarin dhe Vib për Psikologun Klinik dhe Infermierin.
VKM nr. 822 datë, 06/12/2006 "Për miratimin e standarteve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për personat me aftësi të kufizuar ,në qëndrat rezidenciale dhe ditore".
Udhezimi nr. 5 datë 01.08.2012 " Për nivelin e Kuotave të shpezimeve për ushqime në institucionet publike rezidenciale e komunitare të përkujdesit shoqëror", i ndryshuar.

**ii. Synimi i projektit**

- Synojmë ofrimin e shërbimeve alternative për PAN-të, si shërbimin e deinstitucionalizimit dhe parandalimin e institucionalizimit për PAN-të në rrezik, në shtëpi – familjet e projektit "Shpresa" sipas standarteve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për personat me aftësi ndryshe.
- Synojmë t'i japim siguri dhe jetëgjatësi shërbimeve alternative pranë projektit "Shpresa" për PAN-të e braktisur dhe pa përkujdes familjar dhe në vështirësi ekonomiko-sociale.

**iii. Aktivitetet kryesore të projektit**

- Kërkesa nga projekti "Shpresa" për mbështetje me fond për vitin 2020.
- Parashikimi i fondit për projektin "Shpresa" në buxhetin e shtetit për vitin 2020, nga ministria e linjës.
- Nënshkrimi i marrëveshjes midis bashkisë Shkodër dhe projektit "Shpresa" për fondin e parashikuar dhe lëvrimin e tij për vitin 2020.
- Përgatitja e dokumentacionit nga projekti "Shpresa" dhe sjellja e dokumentacionit pranë zyrës së shërbimit social, çdo fillim muaji.
- Paga për 24 kujdestarë, për admistratorin, psikologun klinik dhe infermierin
- Kuota ushqimore e parashikuar për personat që jetojnë në këto shtëpi-familje të projektit "Shpresa", është e llogaritur sipas Udhëzimit nr. 5, datë 01.08.2012 "Për nivelin e kuotave të shpenzimeve për ushqime në institucionet publike rezidenciale e komunitare të përkujdesit shoqëror". Aktualisht në shtëpitë-familje të projektit "Shpresa" jetojnë 58 persona me aftësi ndryshe, nga të cilët 33 prej tyre përfitojnë pensionet e invaliditetit, për të cilët nuk kërkohet kuotë ushqimore nga organizata. 25 persona janë pa pensione invaliditeti për shkak të problematikave dhe mungesave të dokumentacionit. Ne baze të udhëzimit Nr.5 datë 1.8.2012 , "Për nivelin e kuotave të shpenzimeve për ushqime", duke u mbeshtetur në pikën 4 të nenit të Kushtëtutës së Republikës të Shqipërise në zbatim të nenit 24 të ligjit 9355 , datë 10.3.2005, konkretisht pika d ku përcakton: kuota ushqimore për personat e vendosur në qendrat e zhvillimit është 340 lekë në ditë. ( 365 ditë x 15 persona x 340 leke/ditë = 1.861.500 leke/vit)
- Energji Elektrike,
- Përgatitja e relacionit dhe shkresës përcjellëse për lëvrimin e fondit, për Drejtorinë e Financës.
- Monitorimi dhe vlerësimi i ofrimit të shërbimeve në projektin "Shpresa".

-

**b) Rezultatet që prisni**

- Përmirësim i shërbimit të ofruar për PAN-të qe jetojnë në shtëpi-familjet e projektit “Shpresa”.
- Parandalimi i institucionalizimit të personave me AN.
- Mbështetje afatgjatë e sigurtë për klientët që jetojnë në shtëpi – familjet e projektit “Shpresa”.
- Bashkëpunim i ngushtë me organizatën projekti “Shpresa”.
- Përmirësim i situatës së PAN-ve të qytetit të Shkodrës, që janë të braktisur nga familja, duke i sistemuar në projektin “Shpresa”.

| c) Aktorët e mundshëm | d) Kontributet e mundshme në projekt |
|---|---|
| PAN-të që jetojnë në shtëpi-familjet e projektit “Shpresa”<br>Komuniteti<br>Institucionet publike<br>Organizatat | MSHMS<br>Bashkia<br>Projekti “Shpresa” |

**e) Shpenzimet e llogaritura**

| Shpenzimet për çdo aktivitet 2020 | | Totali (mijë lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | Transferim për projektin Shpresa | **19 564** | | | | 19 564 | |
| | **Shuma** | **19 564** | | | | **19 564** | |

| Shpenzimet për çdo aktivitet 2021 | | Totali (mijë lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | Transferim për projektin Shpresa | **19 564** | | | | 19 564 | |
| | **Shuma** | **19 564** | | | | **19 564** | |

| Shpenzimet për çdo aktivitet 2022 | | Totali (mijë lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | Transferim për projektin Shpresa | **20 542** | | | | 20 542 | |
| | **Shuma** | **20 542** | | | | **20 542** | |

| f) Periudha e zbatimit | g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: |
|---|---|
| Janar – Dhjetor 2020<br>2021<br>2022 | Stafi i Drejtorisë së Shërbimit Social Strehimit dhe Shëndetit Publik<br>Stafi i Drejtorisë së Financës<br>Projekti “Shpresa”<br>**Institucioni Likujdues:** Bashkia Shkodër |

| | | |
|---|---|---|
| **Nr. 03** | **Projekti: P10140.O2..A2.**<br><br>Mbështetja e Trupës muzikore të Personave me Aftësi Ndryshe” | **Funksioni 10:** MBROJTJA SOCIALE<br>**N/Funksioni 101:** Sëmundje dhe paaftësi<br>**Llojet e programit 10140:** Kujdesi social për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara |

**a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:**

**i. Situata**

Që nga viti 2005 në qytetin e Shkodrës zhvillon veprimtarinë e saj trupa muzikore The DOOR Albania, e vetmja në rajonin e Ballkanit.
“Trupa muzikore e PAN-ve” përbëhet nga një grup të rinjsh me aftësi ndryshe, të gjithë ish nxënës të shkollës speciale “3 Dhjetori”.
Për të institucionalizuar bashkëpunimin, Bashkia e Shkodrës dhe “The Door” synojnë arritjen e një marrëveshjeje bashkëpunimi me synim qëndrueshmërinë, vazhdimësinë, mbështetjen dhe nxitjen e aktivizimit të kësaj trupe si një model pozitiv i integrimit në jetën social kulturore të fëmijëve me aftësi ndryshe.
Kjo trupë muzikore angazhohet në aktivitete të ndryshme që realizohen në territorin e bashkisë Shkodër, por jo vetëm. Kursi synon integrimin e fëmijëve me aftësi ndryshe të cilët janë shumë të aftë në veglat frymore dhe përmes angazhimit përcjellin mesazhin : Mundësi integrimi për të gjithë.
Disa prej aktiviteteve të parashikuara për pjesëmarrje, por jo vetëm, gjatë vitit 2020 për Trupën muzikore PAN janë:
Festa e karnavaleve
Festa e Lojra Popullore fest
Dita ndërkombëtare e PAK, 3 Dhjetori
Asnjë fëmijë jashtë, dhe aktivitete te ndryshme që mund të bëhen gjatë vitit 2020.

**ii. Synimi i projektit**

- Synojmë promovimin dhe gjithpërfshirjen e PAN në aktivitete social-kulturore.
- Synojmë sensiblizimin e familjeve të PAN-ve dhe komunitetit, për aftësitë e veçanta dhe mundësitë e kësaj kategorie
- Synojmë institucionalizimin e marrëveshjes për qëndrueshmërinë e aktiviteteve të kësaj bande.

**iii. Aktivitetet kryesore të projektit**

- Përgatitja e marrëveshjes me Organizaten The DOOR
- Miratimi dhe nënshkrimi i marrëveshjes së bashkëpunimit
- Zhvillimi i provave sipas një kalendari të paracaktuar gjatë gjithë vitit
- Angazhimi dhe përfshirja e vazhdueshme e trupës nga stafi drejtues
- Pjesëmarrja në aktivitetet e lartpërmendura dhe jo vetëm

**b) Rezultatet që prisni**

- Promovimi dhe gjithëpërfshirja e PAN-ve në aktivitetet social - kulturore
- Sensiblizimi i komunitetit dhe familjeve të PAN-ve
- Përmirësimi i cilësisë së jetës social-kulturore të PAN-ve
- Përfshirja e personave me aftësi të kufizuar

| **c) Aktorët e mundshëm** | d) **Kontributet e mundshme në projekt** |
|---|---|
| Personat me aftësi ndryshe<br>Familjet e personave me aftësi ndryshe<br>Komuniteti<br>Institucionet publike<br>Organizatat | Bashkia<br>Organizatat<br>Komuniteti |

**e) Shpenzimet e llogaritura**

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2020** | | **Totali (mijë lekë)** | **Nga kjo:** | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | **Paga** | **Sigurime** | **Operative** | **Transferime** | **Kapitale** |
| A.1 | Honorar për 1 punonjëse sociale part-time (1 x 12muaj x12 mije leke) | 144 | | | 144 | | |
| A.2 | Honorar për 2 instruktoret e muzikës (2 x12 muaj x 7.25 mije leke) | 174 | | | 174 | | |
| A.3 | Transport | 51 | | | 51 | | |
| | **Shuma** | **369** | | | **369** | | |
| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2021** | | **Totali (mijë lekë)** | **Nga kjo:** | | | | |
| | | | **Paga** | **Sigurime** | **Operative** | **Transferime** | **Kapitale** |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| A.1 | Honorar për 1 punonjëse sociale part-time (1 x 12 muaj x12 mije leke) | **144** | | | 144 | | |
| A.2 | Honorar për 2 inspektorët e muzikës (2 x12 muaj x 7.25 mije leke) | **174** | | | 174 | | |
| A.3 | Transport | **55** | | | 55 | | |
| | **Shuma** | **373** | | | **373** | | |

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2022** | | **Totali (mijë lekë)** | **Nga kjo:** | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | **Paga** | **Sigurime** | **Operative** | **Transferime** | **Kapitale** |
| A.1 | Honorar për 1 punonjëse sociale part-time (1 x 12 muaj x12 mije leke) | **144** | | | 144 | | |
| A.2 | Honorar për 2 inspektorët e muzikës (2 x12 muaj x 7.25 mije leke) | **174** | | | 174 | | |
| A.3 | Transport | **55** | | | 55 | | |
| | **Shuma** | **373** | | | **373** | | |

| | |
|---|---|
| **f) Periudha e zbatimit**<br>Janar – Dhjetor 2020<br>2021<br>2022 | **g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:**<br>Stafi i drejtorisë së shërbimit social,shëndetit publik dhe strehimit<br>Stafi i organizatës "The Door"<br>Drejtoria e financës<br>**Institucioni Likujdues:** Bashkia Shkodër |

| | | |
|---|---|---|
| **Nr. 04** | **Projekti: P10140.O2.A3**<br>Shtëpi Familje për persona me aftësi të kufizuar nga Opera Madonnina del Grappa | **Funksioni 10:** MBROJTJA SOCIALE<br>**N/Funksioni 101:** Sëmundje dhe paaftësi<br>**Llojet e programit 10140:** Kujdesi social për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara |

**a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:**

**i. Situata**

Shkodra sot është një nga qytetet në të cilin ndodhen e funksionojnë shumë institucione e qendra sociale në mbështetje të grupeve sociale në nevojë. Përveç qendrave e institucioneve publike dhe private, tradita e njohur bamirëse shkodrane ka krijuar një klimë nxitëse e pozitive për krijimin e shërbimeve të shumta, të reja e alternative nga organizatat jofitimprurëse vendase e të huaja, nga institucionet fetare dhe individë. Nevojat e mëdha të shkaktuara nga tranzicioni i tejzgjatur dhe "klima" humanitare e qytetarëve tanë kanë krijuar një rrjet mbështetjeje, shërbimesh e përkujdesi për grupet sociale më në rrezik.
Në fillim të viteve 90 organizata të ndryshme filluan ngritjen e shërbimeve të para sociale për grupet me në vështirësi, si motrat e Nane Terezës për përsonat me Aftësi të Kufizuar (AK), Red Barnet në mbështetje të familjeve, Opera Madonnina del Grappa në mbështetje të jetimeve dhe të përsonave me aftësi të kufizuar.

Opera Madonnina del Grappa, është një organizatë e liçensuar që ofron shërbim të përkujdesit social të tipit shtëpi-familje, për PAK të braktisur nga familja dhe të deinstitucionalizuar. Kjo organizatë, është krijuar dhe vepron në qytetin e Shkodrës që prej vitit 1992 ku filloi aktivitetin e saj në mbështetje të përsonave dhe familjeve më në nevojë. Në vitin 1994 filloj ristrukturimin i plotë i ish spitalit psikiatrik të fëmijëve në Shkodër, duke sjelle përmirësimin e kushteve te jetesës dhe trajtimit të fëmijëve por në mënyrë të veçantë ky projekt realizoj krijimin për herë të parë në Shqipëri të Qendrës Ditore për fëmijët më aftësi ndryshe dhe të krijimit të Shtëpisë Familje.

Aktualisht në shtëpinë familje të Opera Madonnina del Grappa marrin shërbim 17 persona me aftësi të kufizuar. Qëllimi i kësaj strukture është rehabilitimi dhe përfshirja në jetën sociale e komunitare nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme me karakter edukativ e integrues duke ju ofruar përfituesve të saj shërbim rezidencial konform standarteve të miratuara nga Ministria e linjës. "Opera Madonnina del Grappa", duke ofruar shërbime alternative për personat me aftësi ndryshe, të cilët janë pa asnjë përkujdes dhe interesim familjar, dhe me problematika të ndryshme, ka nevojë për mbështetje financiare dhe vëmendje të shtetit. Mbështetja e shtëpive – familje të "Opera Madonnina del Grappa" është një domosdoshmëri, për të ofruar shërbimin sipas standarteve të përcaktuara në ligj për personat me aftësi të kufizuara dhe përmbushjen e nevojave sipas rasteve specifike.

Me qëllim sigurimin e vazhdimësisë dhe qëndrueshmërinë e shërbimeve shoqata "Opera Madonnina del Grappa", i është drejtuar vazhdimisht për mbështetje Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Bashkisë Shkodër me kërkesën për financim të shërbimeve, në mbështetje të ligjit nr.121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë".

Në përgjigje të këtyre kërkesave Bashkia Shkodër, i është drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me kërkesën për fonde për mbështetje të "Opera Madonnina del Grappa", për fond për paga dhe sigurime shoqërore për punonjës, si kujdestar social dhe figura profesionale në fusha të ndryshme si: drejtor, ekonomist, psikolog, punonjes social, fizioterapist, infermier dhe kuzhinier, punëtor mirëmbajtës etj. Përveç pagesës për personelin, Bashkia Shkodër do të mbështesë "Opera Madonnina del Grappa" duke mbuluar kuotën ushqimore për personat me aftësi të kufizuar të sistemuar pranë "Opera Madonnina del Grappa", energjinë elektrike, ujë, gaz, karburant, shpenzime mjekësore etj. sipas marrëveshjes së bashkëpunimit mes Bashkisë Shkodër dhe "Opera Madonnina del Grappa".

"Opera Madonnina del Grappa", me kërkesën e dërguar, ka kërkuar që të bëhet shpërndarja e fondeve nga qeveria si qendrat e tjera të ngjashme në vendin tonë, në mbështetje të ligjit nr.121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë".

**Baza ligjore:**

VKM nr. 717, datë 23.06.2009 " Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nënpunësve të disa institucioneve buxhetore", të ndryshuar, (lidhja II,klasa VIII për Kujdestarët Social).

VKM nr. 187 , datë 08.03.2017 "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nënpunësve civilë/nënpunësve, zëvëndësministrit dhe nënpunësve të kabineteve, Kryeministri, Aparatet e ministrive të linjës, Administratën e Presidentit, Kuvendit, KQZ, Gjykatën e Lartë, Prokurorinë e Përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucione në varësi të Kryeministrit, Institucionet në varësi të Kryeministrit, Institucionet në varësi të Ministrave të Linjës dhe administratën e Prefektit, Lidhja I, Klasa IIIb për Titullarin dhe Vib për Psikologun Klinik dhe Infermierin.

VKM nr. 822 datë, 06/12/2006 "Për miratimin e standarteve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për personat me aftësi të kufizuar, në qendrat rezidenciale dhe ditore".

Udhëzimi nr. 5 datë 01.08.2012 " Për nivelin e Kuotave të shpezimeve për ushqime në institucionet publike rezidenciale e komunitare të përkujdesit shoqëror", i ndryshuar.

**ii. Synimi i projektit**

- Promovimi i modelit Shtëpi Familje për përsonat me PAK, pa mbështetje familjare, në vendin tonë.
- Ofrimin dhe zhvillimin e shërbimeve alternative për PAK, si deinstitucionalizimit dhe parandalimin e institucionalizimit për PAK në rrezik dhe rritjen e kapaciteteve të shërbimeve Ditore sipas standarteve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për personat me aftësi të kufizuar.
- Synojmë t'i japim siguri dhe jetëgjatësi shërbimeve alternative pranë "Opera Madonnina del Grappa"," për PAK e braktisur dhe pa përkujdes familjar dhe në vështirësi ekonomiko-sociale.

**iii. Aktivitetet kryesore të projektit**

- Kërkesa nga "Opera Madonnina del Grappa", për mbështetje me fond për vitin 2020.
- Parashikimi i fondit për "Opera Madonnina del Grappa", në buxhetin e shtetit për vitin 2020, nga ministria e linjës.
- Nënshkrimi i marrëveshjes midis Bashkisë Shkodër dhe "Opera Madonnina del Grappa", për fondin e parashikuar dhe lëvrimin e tij për vitin 2020.
- Përgatitja e dokumentacionit nga "Opera Madonnina del Grappa", dhe sjellja e dokumentacionit pranë zyrës së shërbimit social, çdo fillim muaji.
- Kuota ushqimore e parashikuar për personat që jetojnë në këto shtëpi-familje të "Opera Madonnina del Grappa", është e llogaritur sipas Udhëzimit nr. 5, datë 01.08.2012 "Për nivelin e kuotave të shpenzimeve për ushqime në institucionet publike rezidenciale e komunitare të përkujdesit shoqëror". Aktualisht në shtëpitë-familje të projektit "Shpresa" jetojnë 17 persona me aftësi ndryshe. Në bazë të udhëzimit Nr.5 datë 1.8.2012 , "Për nivelin e kuotave të shpenzimeve për ushqime", duke u mbeshtetur në pikën 4 të nenit të Kushtetutës së Republikës të Shqipërise në zbatim të nenit 24 të ligjit 9355 , datë 10.3.2005, konkretisht pika d ku përcakton: kuota ushqimore për personat e vendosur në qendrat e zhvillimit është 340 lekë në ditë.
- Përgatitja e relacionit dhe shkresës përcjellëse për lëvrimin e fondit, për Drejtorinë e Financës.

- Monitorimi dhe vlerësimi i ofrimit të shërbimeve në “Opera Madonnina del Grappa”,

**b) Rezultatet që prisni**

- Përmirësim i shërbimit të ofruar për PAK që jetojnë në shtëpinë-familje të “Opera Madonnina del Grappa”.
- Parandalimi i institucionalizimit të personave me AK.
- Mbështetje afatgjatë e sigurtë për përfituesit që jetojnë në shtëpi – familjet e “Opera Madonnina del Grappa”,
- Përmirësim i situatës së PAK të qytetit të Shkodrës, që janë të braktisur nga familja.

| **c) Aktorët e mundshëm** | **d) Kontributet e mundshme në projekt** |
|---|---|
| PAK që jetojnë në shtëpi-familjet e “Opera Madonnina del Grappa”,<br>Komuniteti<br>Institucionet publike<br>Organizatat | MSHMS<br>Bashkia<br>“Opera Madonnina del Grappa”, |

**e) Shpenzimet e llogaritura**

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2020** | | **Totali (mijë lekë)** | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A. 1 | Transferime për projektin Opera Madonnina del Grappa”, | 16 600 | | | | 16 600 | |
| | **Shuma** | **16 600** | | | | **16 600** | |

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2021** | | **Totali (mijë lekë)** | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A. 1 | Transferime për projektin Opera Madonnina del Grappa”, | 16 600 | | | | 16 600 | |
| | **Shuma** | **16 600** | | | | **16 600** | |

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2022** | | **Totali (mijë lekë)** | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A. 1 | Transferime për projektin Opera Madonnina del Grappa”, | 17 430 | | | | 17 430 | |
| | **Shuma** | **17 430** | | | | **17 430** | |

| **f) Periudha e zbatimit** | **g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:** |
|---|---|
| Janar – Dhjetor 2020<br>2021<br>2022 | Stafi i Drejtorisë së Shërbimit Social Strehimit dhe Shëndetit Publik<br>Stafi i Drejtorisë së Financës<br>“Opera Madonnina del Grappa”<br>**Institucioni Likujdues:** Bashkia Shkodër |